



BASHKIA ELBASAN

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2024 - 2026**

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	6
2. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/QARKUT [EMRI] 2024-2026	8
2.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË ELBASAN NË VITET 2024-2026.....	9
2.1.2 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Elbasan për vitet 2024-2026.....	9
2.1.3 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Elbasan për periudhën 2024-2026.....	13

Lista e Tabelave

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Elbasan	8
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	10
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.	14
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike	17
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	21
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	22
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	Error! Bookmark not defined.
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit	Error! Bookmark not defined.
Tabela 9. Të dhënat e Programit.....	Error! Bookmark not defined.

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksë e tarifave vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësinë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2024-2026 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT).

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përfshijet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË ELBASAN 2024-2026

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Elbasan gjatë periudhës 2024-2026. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2024-2026, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2024-2026. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Elbasan

Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë						
	Të Pergjithshme	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i Njësive Administrative	12.0					
Numri i Fshatrave	104.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	872.0					
<i>Qyteti</i>	-					
<i>Njësitë Administrative</i>	-					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	-					
<i>Zonë Urbane</i>	-					
<i>Tokë Bujqësore</i>	-					
<i>Kullota</i>	-					
<i>Pyje</i>	-					
Popullsia e Bashkisë		213,864.0	214,361.0	212,711.0	215,876.0	-
<i>Qyteti</i>		131,345.0	131,749.0	130,715.0	132,833.0	-
<i>Njësitë Administrative</i>		82,519.0	82,612.0	81,996.0	83,043.0	-
Mosha Mesatare e Popullsisë		-	-	-	-	-
Numri i Lindjeve		-	-	1,440.0	1,201.0	-
Numri i Vdekjeve		-	-	1,748.0	1,015.0	-
Numri i Bizneseve Aktive		6,684.0	6,626.0	6,728.0	6,863.0	-
Numri i Familjeve		69,255.0	70,194.0	69,422.0	69,445.0	-
<i>Qyteti</i>		44,071.0	44,865.0	44,371.0	44,383.0	-
<i>Njësitë Administrative</i>		25,184.0	25,329.0	25,051.0	25,062.0	-
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		1,412.0	1,423.0	1,423.0	1,437.0	1,462.0
<i>Administrata e Bashkisë</i>		485.0	475.0	475.0	460.0	458.0
<i>Njësitë Shpenzuese</i>		927.0	948.0	948.0	977.0	1,004.0
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme		35.0	48.0	161.0	67.0	60.0
<i>Administrata e Bashkisë</i>		5.0	11.0	11.0	11.0	11.0
<i>Njësitë Shpenzuese</i>		30.0	37.0	150.0	56.0	49.0
Numri i Programeve Buxhetore		29.0	31.0	31.0	31.0	21.0

2.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Elbasan 2024-2026

2.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Elbasan për vitet 2024-2026

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit:

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	852,696	1,122,821	1,831,263	1,831,263	1,723,534	1,744,647	1,772,353
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	292,758	525,752	811,682	811,682	822,990	834,572	846,437
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	6,788	1,879	3,000	3,000	3,060	3,121	3,184
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	209,715	207,556	287,382	287,382	293,130	298,992	304,972
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	169,141	171,866	223,062	223,062	227,523	232,074	236,715
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	16,756	16,319	27,480	27,480	28,030	28,590	29,162
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	23,818	19,371	36,840	36,840	37,577	38,328	39,095
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	6,424	8,896	8,500	8,500	8,670	8,843	9,020
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	68,448	76,481	511,500	511,500	516,804	522,263	527,881
A.1.5	Taksa e tabelës	1,383	1,318	1,300	1,300	1,326	1,353	1,380
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vendi	-	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	-	145,249	-	-	-	-	-
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	-	33,748	-	-	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	50,625	-	-	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	141,727	116,756	119,830	119,830	122,227	124,671	127,165
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	20,974	10,436	15,000	15,000	15,300	15,606	15,918
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	80,365	61,144	70,000	70,000	71,400	72,828	74,285
A.2.3	Taksa e rentës minerare	732	572	500	500	510	520	531
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	39,110	44,280	34,000	34,000	34,680	35,374	36,081
A.2.5	Taksa të tjera	546	324	330	330	337	343	350
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	353,612	417,387	573,077	573,077	584,537	596,233	608,153
A.3.1	Tarifa me menaxhimin të mbetjeve	132,406	145,249	185,000	185,000	188,700	192,474	196,323
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	29,653	21,437	62,000	62,000	65,700	69,474	73,323
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	2,206	2,188	2,287	2,287	2,287	2,287	2,287
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	100,547	121,624	120,713	120,713	120,713	120,713	120,713
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	45,334	50,625	65,000	65,000	66,300	67,626	68,979
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	27,362	23,273	43,000	43,000	44,300	45,626	46,979
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	361	606	458	458	458	458	458
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	17,611	26,746	21,542	21,542	21,542	21,542	21,542
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	28,499	33,748	34,000	34,000	34,680	35,374	36,081
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	11,770	9,613	14,000	14,000	14,680	15,374	16,081
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	361	630	458	458	458	458	458
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	16,368	23,505	19,542	19,542	19,542	19,542	19,542
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	79,205	101,460	182,343	182,343	185,990	189,713	193,503
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	1,956	1,651	2,483	2,483	2,533	2,583	2,635
A.3.5.2	Tarifa për dhënie licensave, lejeve e autorizimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	12,410	25,642	65,200	65,200	66,504	67,834	69,191
A.3.5.4	Tarifa për vlosje veterinarije të bagëtive të therura	94	-	-	-	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	1,469	2,306	2,000	2,000	2,040	2,081	2,122
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licënuara dhe vendparkime publike	9,898	11,992	20,000	20,000	20,400	20,808	21,224
A.3.5.7	Tarifa për dhënie licëne për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	8,402	8,400	9,000	9,000	9,180	9,367	9,551

A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	11,241	19,510	45,160	45,160	46,063	46,984	47,924
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja	1,519	1,165	2,000	2,000	2,040	2,081	2,122
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	31,706	29,940	32,500	32,500	33,150	33,813	34,489
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	507	854	4,000	4,000	4,080	4,162	4,245
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	3	-	-	-	-	-	-
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	20,790	23,480	45,354	45,354	46,260	47,186	48,130
A.3.6.1	Bibloteka	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.2	Muzeumet	80	135	120	120	122	125	127
A.3.6.3	Teatri	333	911	900	900	918	936	955
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshtet	15,464	17,237	32,718	32,718	33,372	34,040	34,721
A.3.6.9	Çerdhet	4,913	5,197	11,616	11,616	11,848	12,085	12,327
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	2,494	2,507	2,520	2,520	2,570	2,622	2,674
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	5,144	5,886	5,500	5,500	5,610	5,722	5,837
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	39,740	54,432	53,360	53,360	54,427	55,516	56,626
A.4	Të Ardhurat e Tjera	64,599	62,926	326,674	326,674	193,780	189,171	190,598
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	33,143	32,007	43,714	43,714	44,429	45,154	45,902
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundrvajtjet administrative (Gjobat)	9,512	19,803	20,460	20,460	20,870	21,286	21,712
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	-	16	-	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	2,500	4,438	4,500	4,500	4,590	4,682	4,775
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	19,024	969	2,000	2,000	2,040	2,081	2,122
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	45,000	45,000	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	420	5,693	211,000	211,000	121,851	115,968	116,087
B	Transferta nga Buxheti Qendror	3,152,750	3,313,921	3,522,578	3,522,578	3,573,219	3,627,099	3,684,649
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	710,089	736,685	839,574	839,574	885,289	934,194	986,719
B.2	Transferta e Kushtëzuar	1,981,574	2,099,904	2,190,401	2,190,401	2,190,401	2,190,401	2,190,401
B.2.1	Për funksionet e deleguara	1,970,482	2,017,866	1,977,801	1,977,801	1,977,801	1,977,801	1,977,801
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	11,092	82,038	212,600	212,600	212,600	212,600	212,600
B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	461,087	477,332	492,603	492,603	497,529	502,504	507,529
C	Huamarrja	1,556	2,726	86,100	86,100	-	-	-
C.1	Huamarrja Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-
C.2	Huamarrja Afatgjatë	1,556	2,726	86,100	86,100	-	-	-
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	258,790	313,432	169,600	362,633	-	-	-
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	182,464	217,062	150,000	242,290	-	-	-
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	76,326	96,370	19,600	120,343	-	-	-
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË	4,265,792	4,752,900	5,609,541	5,802,574	5,296,753	5,371,746	5,457,002

2.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Elbasan

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

A.2 Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

B. Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

C. Të Ardhura të Tjera të Veta

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

2.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.

D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 përqind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

2.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

2.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Elbasan për periudhën 2024-2026

Tabela 3, paraqet shpenzimet aktuale, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2021 deri në 2026.

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

PBA 2024-2026								
Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike								
BASHKIA								
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime								
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	892,446.0	900,498.0	1,021,985.0	1,077,545.0	1,021,981.0	1,042,120.0	1,042,120.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	147,492.0	150,632.0	169,846.0	179,206.0	169,850.0	173,209.0	173,209.0
Shpenzime Korente të Tjera								
Mallra dhe Shërbime	602	588,377.0	654,549.0	938,711.0	966,951.0	870,931.0	884,857.0	903,726.0
Subvencion	603	0.0	0.0	5,000.0	5,000.0	5,000.0	5,050.0	7,124.0
Transferta të Brendshme	604	25,206.0	40,016.0	80,808.0	82,808.0	74,534.0	74,684.0	75,017.0
Transferta të Jashtme	605	85.0	30.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	1,945,130.0	2,027,751.0	1,941,423.0	1,942,112.0	1,939,727.0	1,940,547.0	1,942,145.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	83,352.0	83,112.0	94,453.0	95,427.0	94,453.0	94,453.0	94,453.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	12,167.0	8,293.0	10,700.0	10,700.0	10,700.0	10,700.0	10,700.0
Rezervat	609	0.0	0.0	121,973.0	121,973.0	123,623.0	131,731.0	138,866.0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Patrupëzuara	230	17,859.0	9,064.0	28,157.0	28,957.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	228,005.0	300,726.0	1,196,485.0	1,291,894.0	985,954.0	1,014,395.0	1,069,642.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		3,940,119.0	4,174,671.0	5,609,541.0	5,802,573.0	5,296,753.0	5,371,746.0	5,457,002.0

Tabela 4, paraqet shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilin program buxhetor për periudhën 2021-2026.

Tabela 4./4.1 Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike:
SHPENZIMET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (Niveli I, II, III i COFOG)

Kodi	Emërtimi i Funksioneve (Niveli I-re, II-re dhe III-te)	2021	2022	2023		2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti i Pritshem	Plani	Plani	Plani
01	Shërbimet e Përgjithshme Publike	500,771	514,856	598,472	631,741	586,323	596,080	577,080
011	Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme	405,252	423,451	493,319	526,588	586,323	596,080	577,080
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	354,498	372,691	442,519	475,788	586,323	596,080	577,080
01120	Çështje financiare dhe fiskale	50,754	50,760	50,800	50,800	-	-	-
017	Shërbime të huamarrjes vendore	95,519	91,405	105,153	105,153	-	-	-
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	95,519	91,405	105,153	105,153	-	-	-
03	Rendi dhe Siguria Publike	71,539	76,289	232,618	244,920	226,393	236,808	239,927
031	Shërbimet Policore	25,971	30,150	33,200	33,200	33,200	33,893	33,955
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	25,971	30,150	33,200	33,200	33,200	33,893	33,955
032	Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit	45,568	46,139	199,418	211,720	193,193	202,915	205,972
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	45,568	46,139	199,418	211,720	193,193	202,915	205,972
036	Marrëdhëniet me komunitetin	-	-	-	-	-	-	-
03600	Marrëdhëniet me komunitetin	-	-	-	-	-	-	-
04	Çështjet ekonomike	274,814	345,341	882,762	892,687	647,075	663,504	709,297
041	Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	8,479	4,895	3,918	3,918	3,780	3,789	3,789
04130	Mbeshetjet e zhvillimit ekonomik	1,639	1,637	138	138	-	-	-
04160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	6,840	3,258	3,780	3,780	3,780	3,789	3,789
042	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	73,548	105,334	185,808	194,105	182,140	183,764	192,464
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	18,391	24,107	24,723	24,723	23,524	23,808	24,662
04240	Menaxhimi i infrastrukturës në ujtës dhe kullimit	28,153	29,942	50,843	56,951	50,843	51,386	53,645
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	27,004	51,285	110,242	112,431	107,773	108,570	114,157
045	Trasporti	192,787	235,112	673,036	674,664	441,155	450,951	483,044
04520	Rrjeti rrugor rural	136,884	192,819	612,131	613,759	383,795	393,231	421,856
04570	Transporti Publik	55,903	42,293	60,905	60,905	57,360	57,720	61,188
047	Industri të tjera	-	-	-	-	-	-	-
04760	Turizmi	-	-	-	-	-	-	-
049	Çështje Ekonomike (të paklasifikuara)	-	-	20,000	20,000	20,000	25,000	30,000
04910	Fondi Rezervë	-	-	10,000	10,000	10,000	13,000	16,000
04940	Fondi i Kontigjencës	-	-	10,000	10,000	10,000	12,000	14,000
05	Mbrojtja e mjedisit	133,714	161,970	289,008	297,111	271,561	274,895	288,661
051	Menaxhimi i i mbetjeve	124,836	154,032	231,972	239,866	221,175	223,471	231,941
05100	Menaxhimi i mbetjeve	124,836	154,032	231,972	239,866	221,175	223,471	231,941
052	Menaxhimi i ujrave të zeza	2,639	1	48,186	48,395	50,386	51,424	56,720
05200	Menaxhimi i ujërave të zeza	2,639	1	48,186	48,395	50,386	51,424	56,720
053	Reduktimi i ndotjes	6,239	7,937	8,850	8,850	-	-	-
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	6,239	7,937	8,850	8,850	-	-	-
054	Mbrojtja e biodiversitetit dhe bukurisë natyrore	-	-	-	-	-	-	-
05470	Menaxhimi i Qendrueshem i Tokes Bujqesore	-	-	-	-	-	-	-
056	Mbrojtja e mjedisit	-	-	-	-	-	-	-
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	-	-	-	-	-	-	-

06	Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	297,207	274,694	390,612	391,001	373,772	379,067	390,561
061	Urbanistika	2,945	5,003	46,286	46,286	46,286	47,013	47,133
06140	Planifikimi urban vendor	2,945	5,003	46,286	46,286	46,286	47,013	47,133
062	Zhvillimi i komunitetit	185,224	173,436	206,845	207,234	194,811	198,133	207,466
06260	Shërbimet Publike Vendore	185,224	173,436	206,845	207,234	194,811	198,133	207,466
063	Furnizimi me ujë	1,951	-	2,200	2,200	-	-	-
06330	Shërbimet lokale të ujësjellësit	1,951	-	2,200	2,200	-	-	-
06370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	-	-	-	-	-	-	-
064	Ndriçimi i rrugëve	107,087	96,255	135,281	135,281	132,675	133,921	135,962
06440	Ndriçimi i rrugëve	107,087	96,255	135,281	135,281	132,675	133,921	135,962
07	Shëndetësia	2,433	2,340	2,426	2,426	-	-	-
072	Shërbimet e kujdesit parësor	2,433	2,340	2,426	2,426	-	-	-
07220	Shërbimet e Kujdesit Paresor	2,433	2,340	2,426	2,426	-	-	-
08	Argëtimi, kultura dhe feja	116,001	158,391	210,032	243,639	205,532	208,827	212,968
081	Shërbimet rekreative dhe sportive	56,393	84,271	87,632	118,643	87,632	88,792	92,244
08130	Sport dhe argëtim	56,393	84,271	87,632	118,643	87,632	88,792	92,244
082	Shërbimet kulturore	59,608	74,120	122,400	124,996	117,900	120,035	120,724
08220	Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat	59,608	74,120	122,400	124,996	117,900	120,035	120,724
08230	Arti dhe Kultura	-	-	-	-	-	-	-
09	Arsimi	548,579	575,546	997,422	1,084,730	953,485	976,055	996,225
091	Arsimi bazë dhe parashkollor	413,555	406,109	538,478	597,579	499,657	514,512	534,220
09120	Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë	413,555	406,109	538,478	597,579	499,657	514,512	534,220
092	Arsimi parauniversitar	135,024	169,437	458,944	487,151	453,828	461,543	462,005
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	135,024	169,437	458,944	487,151	453,828	461,543	462,005
10	Mbrojtja sociale	1,995,061	2,065,244	2,006,189	2,014,319	2,023,762	2,027,483	2,033,256
101	Sëmundje dhe paaftësi	3,070	3,067	3,500	3,500	-	-	-
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	3,070	3,067	3,500	3,500	-	-	-
104	Familje dhe fëmijë	1,955,795	2,021,663	1,961,083	1,968,239	1,978,857	1,981,307	1,983,042
10430	Përkujdesja Sociale	1,955,795	2,021,663	1,961,083	1,968,239	1,978,857	1,981,307	1,983,042
106	Strehimi social	36,196	40,514	41,606	42,580	44,905	46,176	50,214
10661	Strehimi social	36,196	40,514	41,606	42,580	44,905	46,176	50,214
109	Mbrojtja Sociale (e paklasifikuar)	-	-	-	-	-	-	-
10910	Emergjencat Civile	-	-	-	-	-	-	-
Totali		3,940,119	4,174,671	5,609,541	5,802,574	5,287,903	5,362,719	5,447,975

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT																					
Kodi i Programit	Emri i Programit	2021	2022	2023		2024													Plani Total		
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti i Pritshem	Paga & Sigurime		Të Tjera Korente						Kapitale							
						600	601	602	603	604	605	606	166	651	609	230	231	232		255	
AA109	Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse	500,771	514,856	598,472	631,742	282,400	47,160	82,289	-	23,823	-	-	94,453	10,700	-	-	45,498	-	-	435,672	435,672
AB109	Rendi dhe siguria publike	71,539	76,289	232,618	244,918	64,700	10,769	11,590	-	33,711	-	-	-	-	103,623	-	2,000	-	-	224,393	224,393
AC109	Ceshtjet ekonomike dhe bujqësia	274,814	345,341	862,762	872,687	118,398	19,667	106,068	5,000	-	-	-	-	-	-	-	377,942	-	-	249,133	249,133
AD109	Mbrojtja e mjedisit	135,665	161,970	291,208	299,311	16,200	2,650	209,642	-	-	-	-	-	-	-	-	51,919	-	-	228,492	228,492
AE109	Zhvillimi urban dhe shërbimet publike	295,256	274,694	388,412	388,801	81,700	13,401	218,077	-	-	-	-	-	-	-	-	60,594	-	-	313,178	313,178
AF109	Argetimi kultura dhe sportet	116,001	158,391	210,032	243,639	64,370	10,670	65,100	-	15,000	-	1,500	-	-	-	-	48,892	-	-	155,140	155,140
AG109	Arsimi	551,012	577,886	999,848	1,087,156	329,893	54,890	143,992	-	-	-	51,006	-	-	-	-	373,704	-	-	528,775	528,775
AH109	Mbrojtja sociale	1,995,061	2,065,244	2,006,189	2,014,319	64,320	10,643	34,173	-	2,000	-	1,887,221	-	-	-	-	25,405	-	-	111,136	111,136
AI109	Fondi rezerve dhe kontigjenca	-	-	20,000	20,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	20,000	-	-	-	-	20,000	20,000
TOTALI		3,940,119	4,174,671	5,609,541	5,802,573	1,021,981	169,850	870,931	5,000	74,534	-	1,939,727	94,453	10,700	123,623	-	985,954	-	-	2,265,919	1,042,120

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT																	
Kodi i Programit	Emri i Programit	2025															Plani Total
		Paga & Sigurime		Të Tjera Korente						Kapitale							
		600	601	602	603	604	605	606	166	651	609	230	231	232	255		
AA109	Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse	287,760	48,055	82,289	-	23,823	-	-	94,453	10,700	-	-	49,000	-	-	441,927	
AB109	Rendi dhe siguria publike	65,994	10,984	11,938	-	33,711	-	-	-	-	106,731	-	7,450	-	-	229,358	
AC109	Ceshtjet ekonomike dhe bujqësia	120,756	20,068	107,129	5,050	-	-	-	-	-	-	-	385,501	-	-	253,003	
AD109	Mbrojtja e mjedisit	16,520	2,707	211,738	-	-	-	-	-	-	-	-	52,957	-	-	230,965	
AE109	Zhvillimi urban dhe shërbimet publike	83,334	13,669	220,258	-	-	-	-	-	-	-	-	61,806	-	-	317,261	
AF109	Argetimi kultura dhe sportet	65,657	10,884	65,766	-	15,150	-	1,500	-	-	-	-	49,870	-	-	157,457	
AG109	Arsimi	336,493	55,986	150,539	-	-	-	51,046	-	-	-	-	381,991	-	-	543,018	
AH109	Mbrojtja sociale	65,606	10,856	35,200	-	2,000	-	1,888,001	-	-	-	-	25,820	-	-	113,662	
AI109	Fondi rezerve dhe kontigjenca	-	-	-	-	-	-	-	-	-	25,000	-	-	-	-	25,000	
TOTALI		173,209	884,857	5,050	74,684	-	1,940,547	94,453	10,700	131,731	-	1,014,395	-	-	2,311,651	1,042,120	

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT

2026																
		Paga & Sigurime		Të Tjera Korente							Kapitale				Plani Total	
Kodi I Programit	Emri I Programit	600	601	602	603	604	605	606	166	651	609	230	231	232		255
AA109	Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse	287,760	48,055	82,289	-	23,823	-	-	94,453	10,700	-	-	30,000	-	-	441,927
AB109	Rendi dhe siguria publike	65,994	10,984	12,177	-	33,711	-	-	-	-	108,866	-	8,195	-	-	231,732
AC109	Ceshtjet ekonomike dhe bujqësia	120,756	20,068	107,298	7,124	-	-	-	-	-	-	-	424,051	-	-	255,246
AD109	Mbrojtja e mjedisit	16,520	2,707	220,208	-	-	-	-	-	-	-	-	58,253	-	-	239,435
AE109	Zhvillimi urban dhe shërbimet publike	83,334	13,669	224,663	-	-	-	-	-	-	-	-	68,895	-	-	321,666
AF109	Arëtimi kulturë dhe sportet	65,657	10,884	67,081	-	15,483	-	1,500	-	-	-	-	52,363	-	-	159,105
AG109	Arsimi	336,493	55,986	153,075	-	-	-	51,277	-	-	-	-	399,394	-	-	545,554
AH109	Mbrojtja sociale	65,606	10,856	36,935	-	2,000	-	1,889,368	-	-	-	-	28,491	-	-	115,397
AI109	Fondi rezerve dhe kontigjenca	-	-	-	-	-	-	-	-	-	30,000	-	-	-	-	30,000
		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	173,209	903,726	7,124	75,017	-	1,942,145	94,453	10,700	138,866	-	1,069,642	-	-	2,340,062	-

3. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë ELBASAN menaxhohet sipas Nente programeve të shpenzimeve. Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë. Çdo nën-seksion paraqet informacionin e performancës të planifikuar dhe kostot përkatëse për një program. Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve; dhe
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Tabela 5, paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për dy vitet e mëparshme (faktin), vitin aktual buxhetor (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme të PBA-së (parashikimi).

Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2024-2026								
Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike								
BASHKIA								
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime								
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	892,446.0	900,498.0	1,021,985.0	1,077,545.0	1,021,981.0	1,042,120.0	1,042,120.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	147,492.0	150,632.0	169,846.0	179,206.0	169,850.0	173,209.0	173,209.0
Shpenzime Korente të Tjera								
Mallra dhe Shërbime	602	588,377.0	654,549.0	938,711.0	966,951.0	870,931.0	884,857.0	903,726.0
Subvencion	603	0.0	0.0	5,000.0	5,000.0	5,000.0	5,050.0	7,124.0
Transferta të Brendshme	604	25,206.0	40,016.0	80,808.0	82,808.0	74,534.0	74,684.0	75,017.0
Transferta të Jashtme	605	85.0	30.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	1,945,130.0	2,027,751.0	1,941,423.0	1,942,112.0	1,939,727.0	1,940,547.0	1,942,145.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	83,352.0	83,112.0	94,453.0	95,427.0	94,453.0	94,453.0	94,453.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	12,167.0	8,293.0	10,700.0	10,700.0	10,700.0	10,700.0	10,700.0
Rezervat	609	0.0	0.0	121,973.0	121,973.0	123,623.0	131,731.0	138,866.0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Patrupëzuara	230	17,859.0	9,064.0	28,157.0	28,957.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	228,005.0	300,726.0	1,196,485.0	1,291,894.0	985,954.0	1,014,395.0	1,069,642.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		3,940,119.0	4,174,671.0	5,609,541.0	5,802,573.0	5,296,753.0	5,371,746.0	5,457,002.0

PBA 2024-2026								
Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike								
Programi	AI109	Fondi rezerve dhe kontigjenca						
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga & Sigurime								
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Korente të Tjera								
Mallra dhe Shërbime	602	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Subvencion	603	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Brendshme	604	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Tjera Huamarrje Brendshme (dala)	166	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Interesa për Huamarrje Brendshme	651	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Rezervat	609	0.0	0.0	20,000.0	20,000.0	20,000.0	25,000.0	30,000.0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Patrupëzuara	230	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Aktive të Trupëzuara	231	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzime Transferime Kapitale	232	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të Dala Huadhënie & Nënhuadh. Brendsh.	255	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI		0.0	0.0	20,000.0	20,000.0	20,000.0	25,000.0	30,000.0

3.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në Tabelën 6, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Tabelat 6 – 9 Bashkelidhur